



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 457
Lënda: Parandalimi i duhanpirjes

PROGRAMI I LËNDËS: Parandalimi i duhanpirjes								
Titullari i lëndës:		Enkelejd Mëhilli <i>PhD nëPolitika Shëndetësore</i> _____						
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Lab	Praktikë	Projekt klinik		
	3	15	8	0	10	0	42	75
Tipologjia e lëndës		Disiplinë e formimit karakterizues të programit						
Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri I						
Lloji i lëndës		Me zgjedhje						
Programi i studimit		Master Profesional në Infermieri Patologjike						
Kodi i lëndës		INF 457						
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		mechili@univlora.edu.al mechili@uoc.gr						

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda është ngritur me një qasje pragmatike për një te ardhmeje pa duhan, ne te cilen asnje European nuk do te duhet te vuaje nga semundje te lidhura me duhanin dhe vdekje te parakohshme. Është e rëndësishme që të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor të njihen me teknikat më të fundit për të ndihmuar pacientët e tyre me ndërprerjen e pirjes së duhanit dhe që të ndihen rehat duke përdorur terapitë e bazuara në prova gjatë praktikës së përditshme klinike. Duhanpirja përben një varësi të fortë, dhe qëllimi ynë është të krijojmë një koherencë të gjerë midis aktiviteteve parandaluese për duhanin, si dhe promovimin e politikave gjithëpërfshirëse të kontrollit të duhanit në nivel europian dhe kombëtar. Nderhyrjet per ndërprerjen e duhanpirjes kane nje ndikim afatmesem mbi numrin e vdekjeve dhe per kete arsye duhen inkurajuar.</p>
Objektivat e lëndës	<p>Kjo lëndë ka për qëllim tu ofrojë profesionistëve të kujdesit shëndetësor njohuritë e praktikave më të mira të bazuara në prova, për të ofruar trajtim të duhanit tek pacientët e tyre. Ky kurs konsolidon provat dhe këshilla praktike për përfshirjen e këtyre provave në praktikën klinike dhe bën rekomandime për ndërhyrje efektive të duhanit për të përmirësuar rezultatet shëndetësore.</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Rezultatet e pritshme	<p>Në përfundim të lëndës studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none">☞ Të kenë njohuri për aspektet fizike dhe psikologjike të varësisë nga nikotina dhe patofiziologjisë së varësisë nga nikotina dhe të kuptojnë simptomat tipike të tërheqjes dhe dëshirave;☞ Të jenë në gjendje të integrojnë trajtimin e varësisë së bazuar në dëshmi në praktikën klinike duke përdorur strategjitë 5As dhe duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion për të ndihmuar profesionistët dhe pacientët e kujdesit shëndetësor;☞ Të kuptojnë rolin e këshillimit në ndihmën për pacientët dhe rritjen e njohurive për teknikat e ndryshimit të sjelljes të përdorura për të mbështetur ndërprerjen e pirjes së duhanit duke përfshirë këshillimin kognitiv të sjelljes;☞ Të Përshkruajnë teknikat e këshillimit të rekomanduara për të rritur motivimin e pacientit për të lënë duhanin dhe parimet kryesore të intervistimit motivues;☞ Të njihen me farmakoterapinë e duhanit të linjës së parë, duke përfshirë përdorimin e tyre të duhur për të maksimizuar rezultatet e ndërprerjes.
------------------------------	--

KONCEPTET THEMELORE

- Koncepte bazë të farmakoterapisë për ndalimin e duhanit;
- Koncepte bazë në përdorimin e metodës së 5As;
- Përgatitja e personelit shëndetësor për përdorimin e intervistimit motivues;
- Ndërhyrjet standarte për trajtimin e duhanit.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
1	<p>Tema 1 – Vlerësimi i përdorimit të duhanit dhe varësisë ndaj duhanit <i>Perkufizimet, klasifikimet, termat dhe shjegimet specifike, Varesia ndaj nikotines sipas OBSH</i></p> <p>Tema 2 - Duhanpirja është një sëmundje kronike <i>Trajtimi i varesisë ndaj duhanit pas ndërprerjes, Diagnozatat klinike të përdorimit dhe varesisë ndaj duhanit,</i></p> <p>Seminar 1 - Monitorimi fillestar <i>Vlerësimi klinik i Anksitetit dhe Depresionit, Diagnozatat laboratorike për varesinë ndaj duhanit</i></p>	<p>⁽¹⁾Fq. 11-17</p> <p>⁽¹⁾Fq. 17 - 24</p> <p>⁽¹⁾Fq. 19 – 23</p>	<p>Leksion 1 orë Leksion 1 orë Seminar 1 orë</p>
2	<p>Tema 3 - Rekomandime të përgjithshme për trajtimin e duhanpirjes dhe varësisë ndaj duhanit <i>Përdorimi i duhanit, sëmundja e varesisë ndaj duhanit, Nderpreja e duhanit</i></p> <p>Seminar 2 - Edukimi terapeutik <i>Mjekimi farmakologjik, Nderpreja e duhanit</i></p>	<p>⁽¹⁾Fq. 25 - 28</p> <p>⁽¹⁾Fq. 25 - 28</p>	<p>Leksion 1 orë Seminar 1 orë</p>
3	<p>Tema 4 - Këshilla të shkurtra për ndërprerjen e përdorimit të duhanit <i>Rekomandime të përgjithshme</i></p>	<p>⁽¹⁾Fq. 28 - 32</p>	<p>Leksion 1 orë</p>
4	<p>Tema 5 - Ndërhyrjet standarte për trajtimin e duhanit <i>Ndërhyrjet terapeutike për përdorimin e duhanit dhe varesinë ndaj duhanit,</i></p> <p>Seminar 3 - Metodatat standarte për ndërprerjen e duhanpirjes <i>Mbështetja gjatë ndjekjes në vazhdimësi, Llojet e ndërhyrjeve për ndërprerjen e duhanit</i></p> <p>Praktikë 1 - Konsulencë për sjelljen <i>Suporti psikologjik për ndërprerjen e duhanpirjes</i></p>	<p>⁽¹⁾Fq. 33 - 44</p> <p>⁽¹⁾Fq. 36 – 43</p> <p>⁽¹⁾Fq. 44 - 48</p>	<p>Leksion 1 orë Praktikë 1 orë Seminar 1 orë</p>
5	<p>Tema 6 - Interviste motivimi <i>Mënyra intervistës motivuese</i></p> <p>Praktikë 2 - Interviste motivimi në praktikë</p>	<p>⁽¹⁾Fq. 48 - 56</p>	<p>Leksion 1 orë Praktikë 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<i>Parimet themelore dhe mënyrat e aplikimit, shembuj të strategjisë së sjelljeve</i>	⁽¹⁾ Fq. 53 - 57	
6	Tema 7 - Trajtimi farmakologjik i varesisë ndaj duhanit <i>Trajtimi me NRT dhe bupropion</i> Seminar 6 - Skema terapeutike individuale <i>Përdorimi i skemave individuale në bazë të nevojave të pacientit</i> Praktikë 3 – Aplikimi i intervistës motivuese <i>Punë në grup</i>	⁽¹⁾ Fq. 57 - 75 ⁽¹⁾ Fq. 85 – 87	Leksion 1 orë Praktikë 1 orë Seminar 1 orë
7	Tema 8 - Trajtimi farmakologjik i varesisë ndaj duhanit <i>Trajtimi me varenicline</i> Praktikë 4 – Raste të ndryshme dhe aplikimi i tyre <i>Punë në grup</i>	⁽¹⁾ Fq. 75 - 85	Leksion 1 orë Praktikë 1 orë
8	Tema 9 - Trajtimi farmakologjik i varesisë ndaj duhanit <i>Trajtimi me clonidine, nortriptyline dhe Cytisine</i> Seminar 7 - Rekomandime për metodat e reduktimit të duhanpirjes <i>Reduktimi i duhanpirjes nepermjet zevendesimit te nikotines</i>	⁽¹⁾ Fq. 79 – 85 ⁽¹⁾ Fq. 96 - 98	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
9	Tema 10 – Trajtime të rekomanduara <i>Stratagjitë e sjelljes, Përdorimi i medikamenteve</i>	⁽¹⁾ Fq. 98 - 104	Leksion 1 orë
10	Seminar 7 - Trajtimet e rekomandura për gratë shtatzane dhe për personat nën 18 vjeç <i>Trajtimi për popullata specifike</i> Praktikë 5 – Raste të ndryshme dhe aplikimi i tyre <i>Punë në grup</i>	⁽¹⁾ Fq 100 - 103	Seminar 1 orë Praktikë 1 orë
11	Tema 11 - Kërkime dhe Rekomandime Shkencore për të Vlerësuar Ndërprerjen e Duhanpirjes <i>Kriteret e kerkimit shkencor klinik ne Nderprerjen e Duhanpirjes</i> Seminar 8 - Trajtime të rekomanduara për personat duhanpires me probleme respiratore, kardiovaskulare, psikiatrike, kancer dhe semundje të tjera shoqeruese <i>Trajtimi për popullata specifike</i>	⁽¹⁾ Fq. 114 - 116 ⁽¹⁾ Fq. 104 - 110	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
12	Tema 12 - Kosto-Efektiviteti i terapive për varesinë ndaj duhanit <i>Matja e koston dhe efektivitetit të terapive për duhanin</i> Seminar 9 – Shtimi i peshes <i>Rekomandime për nderhyrjet mbi shtimin ne peshe pas nderprerjes se duhanpirjes</i>	⁽¹⁾ Fq. 113 - 116 ⁽¹⁾ Fq. 111 - 112	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
13	Tema 13 - 14 Nderprerja e Duhanpirjes <i>Rekomandime per implementimin e guides, Literatura Shkencore e Rekomandur</i> Praktikë 6 – Raste të ndryshme dhe aplikimi i guidës <i>Punë në grup</i>	⁽¹⁾ Fq. 116 - 118	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Praktikë 1 orë
14	Tema 15 – Shërbimet e Ndërprerjes së duhanit <i>Standartet Europiane, Trajnimet për Ndërprerjen e Duhanpirjes</i> Praktikë 7 - Nivelet e shërbimeve për ndërprerjen e duhanpirjes <i>Raste specifike</i>	⁽¹⁾ Fq. 119 - 130	Leksion 1 orë Praktikë 1 orë
15	Praktikë 8 – 10 Prezantimi i detyrave të kursit të përgatitur në grup		Praktikë 3 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:

Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 75%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrëveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).

Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.

MËNYRA E VLERSIMIT	Forma e vlerësimit	Koha e vlerësimit	Temat mësimore që do vlerësohen	Pikët maksimale	Forma e testimit të njohurive	Përmbajtja e testimit
	Detyrë kursi*	Java e 15	Projekt në grup	20 pikë	Prezantim në klasë dhe diskutim	Përmbajtja e saktë e temës së diskutuar
Provim final	Fundi i semestrit	Temat 1-15	80 pikë	Provim me shkrim	Pyetje me qëllim rritjen e aftësive të mendimit kritik të studentëve	
<i>* Detyra e kursit - Kjo do t'i japë studentëve mundësinë për të bashkëpunuar në grupe dhe për të prezantuar se si përgatitet një kërkim shkencor.</i>						
Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:						
40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë	
5	6	7	8	9	10	

LITERATURA

Literatura bazë e detyruar	⁽¹⁾ Guida për trajtimin e varësisë ndaj duhanpirjes. European for Smoking and Tobacco Prevention. ENSP.
Literatura e rekomanduar	○ Smoking cessation: training materials. Tobacco free initiative (TFI). WHO.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto prishmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
-------------------	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.